



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 157 prot.

Kamëz, më 18 . 12 . 2023

V E N D I M

Nr 112 Datë 18/12/2023

P Ë R

“MIRATIMIN E VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2024”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.12.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.80 Datë 13.12.2023, në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”; Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore”; Udhëzimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”;
Këshilli Bashkiak Kamëz:

V E N D O S I :

1. Miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr.Frymësh	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1-2	1	15,000
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	3-4	1	18,000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)		5	1	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

		muaj			24,000
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	6-8	1	27,000

2. Vlera e subvencionimit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në treg sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

